



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr.72, datë 28.06.2021

PËR

MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT PREJ 20'935'657 LEKË ME TVSH, I CILI DO TË MERRET NGA FONDI I MIRATUAR ME VKB-NË NR.34 DATË 31.03.2021, PËR PËRFORCIMIN E TERRENIT NGA RRËSHQITJA E DHERAVE NË ZONËN E NDODHUR NË LAGJA NR.10 NË KODËR PRANË CURRILAVE NGA ANA VERIORE E PERËNDIMORE E SAJ DHE PËR OBJEKTIN E NDODHUR NË FAQEN E KODRËS NË FSHATIN SHKALLNUR NË NJËSINË ADMINISTRATIVE RRASHBULL

Në zbatim të Ligjit Nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit Nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit Nr. 137/2020, ”Për buxhetin e vitit 2021”, Ligjit Nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të buxhetit”, VKB-së Nr.123, datë 24.12.2020 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2021 si dhe projektbuxhetin afat mesëm të Bashkisë Durrës për vitet 2021-2023”, si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Projekteve dhe Investimeve Publike dhe Drejtoria e Buxhetit, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e përdorimit të fondit prej 20.935.657 lekë me tvsh, për përforsimin e terrenit nga rrëshqitja e dherave për objektet e ndodhura në :

- a. zonën e ndodhur në lagja nr.10 në kodër pranë Currilave nga ana veriore e perëndimore e saj, në vlerën 12'936'233 lekë me tvsh dhe
 - b. në faqen e kodrës në fshatin Shkallnur në Njësinë Administrative Rrashbull, në vlerën 7'999'424 lekë me tvsh.
2. Fondi do të merret nga fondi i miratuar me VKB-në Nr.34, datë 31.03.2021 “Për miratimin e fondit prej 30.438.583 lekë me tvsh, për përforsim terrenit nga rrëshqitja në zonat e Njësisive Administrative nr.2, nr.4, Rrashbull dhe Ishëm”.
 3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Projekteve dhe Investimeve Publike.
 4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 28.06.2021



BASHKIA DURRES
Dt: 06/7/21 Nr. 7438/11 PROT

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 461/1 prot.

Durrës, më 06.07.2021



Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK

DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr. 72 datë 28.06.2021 Për miratimin e përdorimit të fondit prej 20'935'657 lekë me TVSH, i cili do të merret nga fondi i miratuar me VKB-në nr.34 datë 31.03.2021 "Për përforcimin e terrenit nga rrëshqitja e dherave në zonën e ndodhur në lagja nr.10 në kodër pranë Currilave nga ana veriore e perëndimore e saj dhe për objektin e ndodhur në faqen e kodrës në fshatin Shkallnur në Njësinë Administrative Rrashbull".

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

